

Recension

Operacionalizimi i një korpusi gjuhësor

Mr. Agim Spahiu

20 qershor 2002

Përmbledhje

Ky shkrim prezanton studimin "*Operationale Grammatik des Deutschen, Ein Skizze*" të Karl-Ernst Sommerfeld-it, me të vetmen arsye që lexuesit shqiptarë ta kenë një pasqyrë të qartë se ç' mund të përmbajë ky studim i njohur në gjuhën gjermane, ndërsa studiuesit ta kenë para vetes një doracak i cili mund të jetë një udhërrefyes i mirë ose një pikëreferim për të hartuar ndonjë studim të ngjashëm edhe në gjuhësinë shqiptare, kuptohet duke u mbështetur në këtë metodologji.

Një prej parimeve të gjuhësisë strukturaliste është edhe operacionalizimi i korpusit gjuhësor i mbështetur në rregullat gramatikore e semantike të një gjuhe, siç janë: *permutacioni, substituimi, komutacioni, eliminimi, transformacioni* etj.

Me këto dhe çështje të tjera ka kohë që merren studiuesit gjermanë, të cilët për bazë kanë metodën operacionale, e në mënyrë të veçantë, shquhet studiuesi Karl-Ernst Sommerfeldt. Ky autor, vite më parë, pikërisht më 1993, ka botuar studimin (156 fq.) me titull "*Operationale Grammatik des Deutschen, Eine Skizze*", i cili, për nga mënyra e shtjellimit dhe e trajtimit të materies gjuhësore përbën një avansim në fushën hulumtimit dhe të studimit gjuhësor në këtë gjuhë.

Në këtë shkrim nuk kemi mundësi t'i prezantojmë të gjitha këto çështje një për një, sepse nuk lejon natyra e këtij shkrimit, por do të ndalemi në disa më kryesoret, duke bërë më tepër një prezantim të përmbajtjes së kapitujve në vija të përgjithshme.

Libri ndahet në pesë kapituj:

1. Esenca dhe llojet e operacioneve gjuhësore
2. Operacionet bazë - krijimi i fjalive nga struktura e tyre themelore
3. Operacionet mbi shtrirjen situative, d.m.th. komunikative, duke u mbështetur nga përshkrimi i raporeve ndërmjet gjërave (sendeve)
4. Variantet-ndryshimet nga struktura themelore; dhe
5. Operacionet mbi të cilat testohen ndërtimet sintaksore

Në kapitullin e parë flitet teorikisht për esencën, llojet dhe nocionet gramatikore; për përdorimin e operacioneve dhe për një klasifikim të mundshëm të tyre.

Kapitulli i dytë "*Operacionet bazë - krijimi i fjalive nga struktura e tyre themelore*" ndahet në dy pjesë: Pjesa e parë "*Bazat teorike*" ka të bëjë me formën, esencën dhe llojet e gjedheve semantike të fjalive; me llojet e fushave gjuhësore (fusha leksikore dhe fusha gramatikore), ndërsa pjesa e dytë "*Operacionet mbi krijimin e fjalive*" ku flitet gjerësisht për operacionet themelore gramatikore në kuadër të pranëvënies, të nënrenditjes dhe të bashkërenditjes, dhe për ato leksikore, siç janë: operacionet e krijuara nga raportet valencore, shkakore dhe kundërshtore (f. 30 - 65).

Në këtë kapitull flitet mjaft gjerësisht për aktantët obligativë dhe fakultativë.

Edhe kapitulli i tretë "*Operacionet mbi shtrirjen situative, d.m.th. komunikative nga përshkrimi i raporteve ndërmjet gjërave (sendeve)*" është ndarë në dy pjesë: Pjesa e parë ka të bëjë me operacionet mbi shtrirjen leksikore (përbërësit e kohës absolute dhe relative), kurse e dyta shtjellon operacionet me të cilat shprehet modaliteti.

Kapitulli i katërt "*Variantet - ndryshimet nga struktura themelore*" ndahet në pesë pjesë: Në të parën bëhet fjalë për ndryshueshmërinë e llojeve të fjalive nga aspekti i kumtimit; në të dytën për ndryshueshmërinë e trajtave (formave) të fjalive; në të tretën për reduktimin e fjalive të thjeshta dhe atyre komplekse (të përbëra); në të katërtën për reduktimin nga fjalitë në kompozita, dhe në të pestën për disa variante të krijimit të fjalive (vështruar nga funksioni logjik-gramatikor, strukturor-gramatikor, emocional dhe komunikativ-psikologjik (f. 139).

Kapitulli i pestë "*Operacionet mbi testimin e ndërtimeve sintaksore*" u kushtohet kryesisht atyre veprimeve gjuhësore që u përmenden në fillim të këtij shkrimi.

E bëme këtë prezantim të këtij studimi jo pa arsye, por me të vetmin qëllim dhe synim se edhe studiesit tanë që merren me probleme të gjuhësisë, do të ishte mirë të mbështeten në këtë metodë, pra në metodën operacionale, sepse mendojmë se është metoda më e kapshme, më e lehtë për t'u përvetësuar dhe shumë më produktive, sesa ato që janë përdorur dhe po përdoren në tekstet tona shkollore e universitare. Nga kjo metodë mund të shihet se cilat ndërtime sintaksore mund të zbërthehen dhe cilat jo, nga një ndërtim në tjetrin; cilat rregulla mundësojnë një ndërtim a transformim dhe cilat jo; cilat komponente duhet të merren për bazë për të vlerësuar se cilat janë ndërtime të drejta dhe cilat jo dhe shumë çështje të tjera që përkojnë apo jo me natyrën e me normat e një gjuhe, në përgjithësi. Por në këtë aspekt nuk duhen harruar as specifikat e secilës gjuhë veç e veç, pra edhe të shqipes. Dhe, për të gjitha këto një model i mirë do të jetë studimi i sipërpërmendur.